



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 360/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha, dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së banerave mbi rrugët publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 28.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Dardanë, me të cilën pretendohet se më 26.10.2013 në Lagjen Malësia në Dardanë, anëtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kanë vendosur banerë të kandidatit për asamble nga ky subjekt politik Faton Krasniqi mbi rrugë publike. Sipas parashtresës të ankesës është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) të LZP, dhe nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013. Parashtresë i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 28.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 29.10.2013, në ora 16:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK sipas afatit të caktuar, ku konsideron se janë të pa baza pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me shkeljen e Rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b) të LZP dhe nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013. Po ashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se vendosja e posterit të Kandidatit të AAK-së për Asamble Komunale në Dardanë Faton Krasniqi mbi rrugë publike nga fotografia e ofruara në ankesë nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se baneri i kandidatit të subjektit politik AAK, është i vendosur mbi rrugë publike , nuk qëndrojnë sepse nuk është ofruar dëshmi bindëse nga parashtruesi i ankesës të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk mund të vërtetohet shkelja e supozuar. Andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur PZAP-i vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 360/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*